

"Gojda" shpk

Adresa: Yzberisht, Rruga Tre Deshmoret, Tirane

Email: gojdashpk@gmail.com

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERIS ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"Gojda" shpk**

Ne Tirane, sot me date 13.09.2024 (Trembedhete , Shtator, dy mije e njezete e kater), u paraqit personalisht ortaku themelues: **Eljona Valter Gojda, datelindja 15.10.1990**, lindur ne Vlore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me Nr. personal J06015106M , banuese ne Tirane.

Deklaroj me vullnetin tim te plote e te sinqerte dhe me iniciativen time te lire dhe private mbeshtetur ne kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe kodin civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ligjin 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, te krijoj shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar me emertim "**Gojda**" sh.p.k

**KREU I**  
**Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti.**

Shoqeri e cila do te merret me: Këmbim Valutor; Transferim të Parave në emër dhe për llogari të institucionit financiar jo Bankë; Ushtrimi i veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime si agjent; Ushtrim i ndërmjetësimit të pagesave utilitare; Ushtrimin e veprimtarisë së agjentit të shërbimeve telefonike dhe celulare; Shoqëria ka të drejtë të kryej shërbimet e transfertave të parave, shërbimin e pagesave, komisionerit dhe shkëmbimit të vlerave monetare ( exchange ) për llogari të saj apo të çdo subjekti financiar jobankë. Ushtrimi i veprimtarisë si agjent Postar. Gjithashtu, për të realizuar objektivat e saj, shoqëria mund të ndërmarrë e të zhvillojë edhe çdo lloj aktiviteti tjetër të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqiperisë dhe që siguron të ardhura dhe fitime te ligjshme.

**Neni 1**  
**Emertimi**

Emertimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte " **Gojda**" sh.p.k

**Neni 2**  
**Forma Juridike**

Shoqeria "**Gojda**" shpk eshte nje shoqeri tregtare, e themeluar nga ortaket e shoqerise, te cilet pergjigjen per detyrimet e shoqerise tregtare dhe mbulojne personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara. Kontributi i ortakeve perben kapitalin e regjistruar te shoqerise. Ortaket gezojne kuoten e tyre ne shoqeri, ne perpjestim me kontributin qe kane dhene ne kapital.

*Eljona Gojda*  
*Egy*

“Gojda” shpk

Adresa: Yzberisht, Rruga Tre Deshmoret, Tirane

Email: gojdashpk@gmail.com

### Neni 3

#### Selia

Selia e shoqërisë është Tirane, Rruga Tre Deshmoret, Yzberisht, nr. pasurie 368/14+2-N1, Volumi 66, Faqe 56, Zona kadastrale 3866. Shoqëria mund të ndryshojë zyren e saj, të hap zyra perfaqësie, dege, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.

### Neni 4

#### Objekti i veprimtarisë

#### Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtem (vetëm nëse është i përcaktuar)

Këmbim Valutor; Transferim të Parave në emër dhe për llogari të institucionit financiar jo Bankë; Ushtrimi i veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime si agjent; Ushtrim i ndërmjetësimit të pagesave utilitare; Ushtrimin e veprimtarisë së agjentit të shërbimeve telefonike dhe celulare; Shoqëria ka të drejtë të kryej shërbimet e transfertave të parave, shërbimin e pagesave, komisionerit dhe shkëmbimit të vlerave monetare ( exchange ) për llogari të saj apo të çdo subjekti financiar jobankë. Ushtrimi i veprimtarisë si agjent Postar. Gjithashtu, për të realizuar objektivat e saj, shoqëria mund të ndërmarrë e të zhvillojë edhe çdo lloj aktiviteti tjetër të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që siguron të ardhura dhe fitime të ligjshme

### Neni 5

#### Kohezeia

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të përcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në regjistrin tregtar. Shkurtimi i kësaj kohezgjatjeje në rastin e një prishjeje të pershpejtuar të shoqërisë ose zgjatja e afatit, duhet të bëhet me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.

## KREU II

### KAPITALI

### Neni 6

#### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 2.500.000 (dy milion e pesëqind mijë) leke. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre .

Personat që zoterojnë 100% të kapitalit në shoqëri janë:

100% të kapitalit në shoqëri i zoteron ortakja e vetme Eljona Gojda.

Kapitali i korrespondon 1 kuote në vlerën 2.500.000 (dy milion e pesëqind mijë) leke.

Kontributi i ortakut mund të jete në para ose në natyrë.

*Eljona Gojda*  
*Etz*

“Gojda” shpk

Adresa: Yzberisht, Rruga Tre Deshmoret, Tirane

Email: gojdashpk@gmail.com

**Neni 7**  
**Transferimi i kapitalit.**

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- c) dhurimit;
- d) cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kushtet dhe momenti i kalimit te titullit te pronesise mbi kuoten si dhe kushtet e tjera te kalimit ,perfshire momentin e pageses se cmimit ,rregullohen nga kontrata. Kontrata per kalimin e kuotes hartohet ne forme shkresore dhe noterizimi nuk perben kusht per vlefshmerine apo regjistrimin e kontrates. Me perjashtim te rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palet bien dakort ne kontrate, vlefshmeria kalimit te titullit te pronesise mbi kuotat nuk do te kushtezohet nga kryerja e formaliteteve te ndryshme me efekt deklarativ , perfshi ketu formalitetet e regjistrimit ose te publikimit te kontrates apo te kalimit te titullit.

**KREU III**  
**ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE**

**Neni 8**  
**Organi Vendimarrës**

Asambleja e Ortakeve te Shoqerise eshte organi i vetem vendimarrës i shoqerise, qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Ortaket e shoqerise jane pergjegjes per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- d) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- e) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "g" te kesaj pike;
- f) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve to ecurise se veprimtarise;
- h) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- i) pjesetimin e kuotave dhe anullimin e tyre;
- j) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- l) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- m) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.

*Eljona Gojola*  
*Elj*

“Gojda” shpk

Adresa: Yzberisht, Rruga Tre Deshmoret, Tirane

Email: gojdashpk@gmail.com

Administratori i shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

### Neni 9

#### Marria e vendimeve

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres per ceshtje te tjera si:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- g) percaktimin e shperblimeve,
- d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarist;
- e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve,
- f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

### Neni 10

#### Administrimi

(1) Asambleja e pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet, me te drejte riparteritjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

(2) Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar e anasjelltas. Çdo emerim i bere ne kundërshtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.

(3) Personat e meposhtem caktohen si Administratore te pare te shoqerise deri ne emerimin e tyre nga mbledhja e pare e Asamblese se Pergjithshme.

Te dhenat e identifikimit: dhe specimenet e nenskrimit:

Administratori i shoqerise do te jete Znj. Eljona Gojda, lindur me 15.10.1990, ne Vlore, identifikuar me nr. personal Leternjoftimi J06015106M.

### Neni 11

#### Kompetencat

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- a) kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) perfaqesoje shoqerine tregtare;

*Eljona Gojda*  
*Goj*

“Gojda” shpk

Adresa: Yzberisht, Rruga Tre Deshmoret, Tirane

Email: gojdashpk@gmail.com

- c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe librave kontabel te shoqerise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shpermdarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
- d) krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- e) kryeje regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit;
- f) raportoje perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- g) kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Administratori eshte i detyruar te therrasi mbledhjen e ortakeve edhe ne rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te lane se 5 per qind te aseteteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara,

Nese asambleja e pergjithshme emerom me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkarisht shoqerine.

Asambleja e pergjithshme, mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe, me shumice te zakonshme. Padite qe lidhen me shperblimin e administratorit ne haze te maredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

## Neni 12

### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

## Neni 13

### Prishja dhe likuidimi

Shpermdarja ose prishja e shoqerise mund to behet ne cdo kohe

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit"; me vendim te gjykates;

*Eljona Gojda*  
*Egy*

“Gojda” shpk

Adresa: Yzberisht, Rruga Tre Deshmoret, Tirane

Email: gojdashpk@gmail.com

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likudim e siper"

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likujdimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimenti.

Likujdimi kryhet nga likujduesit e emeruar nga Ortaket.

Nese ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likujduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likujdues.

#### Neni 14 Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin ne perputhje te plote me kete akt themelimi, statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerit tregtare", Kodit Civil dhe cfardo ligji tjetër specifik ne Republiken e Shqiperise.

#### Neni 15 Mosmarveshjet

Per mosmarveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statute, si dhe per çdo mosmarveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Ortaku i vetem i shoqerise si themelues i saj pasi e lexoi me vemendje akt themelimin e mesiperm dhe duke qene konforme vullnetit te saj, e firmosi pa verejtje.

#### **ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE**

**"Gojda" shpk**

**Eljona Gojda**

*Eljona Gojda*  
*EG*